



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 156/prot.

Tiranë, më 10.12.2024

VENDIM

Nr. 156, datë 10.12.2024

PËR

DISA NDRYSHIME NË DIREKTIVAT E VLEFSHMËRISË AJRORE TË PRANUARA ME VENDIMIN NR. 121, DATË 08.11.2024 "PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E DISA DIREKTIVAVE TË VLEFSHMËRISË AJRORE PËR ZBATIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 79, DATË 15.04.2024"

Në mbështetje të neni 14, pika (ë), të Ligj Nr.53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil" dhe në zbatim të pikës M.A.303, Pjesa M, Seksioni A, Nën pjesa C, e Urdhrit të Ministrit Nr.79, datë 15.04.2024, për miratimin e rregullores "Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra",

V E N D O S A

1. Direktiva e vlefshmërisë ajrore ACAA-DFS-AD-No.0024, Issue 01, Revision 00, pranuar dhe publikuar me Vendimin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 121, datë 08.11.2024, ndryshohet dhe zëvendësohet me direktivën e vlefshmërisë ajrore si më poshtë:
 - me EASA AD No.: 2024-0201R1, ATA 57 – Wings – Outer Wing Bottom Buttstrap – Inspections me kod ACAA-DFS-AD-No.024 Issue 01, Revision 01;
2. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit, në veçanti Sektori i Vlefshmërisë Ajrore, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit të marrë masa për njoftimin apo publikimin për zbatim nga operatorët të Direktivave të mësipërme.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.
5. Direktiva e ndryshuar ACAA-DFS-AD-No.024 i bashkëlidhet këtij vendimi.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

